

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "BATI BISTRO" Sh.p.k.

Sot, me datë 03 / 11 / 2022,

Z. Mariglen Gjata, shtetas shqiptar, atësia Genci, lindur më 03.10.1995, në Tiranë, banues në: Bejte Bulticë 0400011; Nd 5, H 1, Bejte, Bulticë, Vaqarr, Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 031451156 me ID J51003115P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**BATI BISTRO" Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**BATI BISTRO" Sh.p.k.**

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njësia Bashkiake Nr. 2, Blv Zhan Dark, njësia me nr pasurie 5/532+2+-N9, zonë kadastrale nr. 8150, volum 49, faqe 53, sipërfaqe 108 m2, në krah të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Tiranë, Shqipëri.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Bar-Restorant, shërbime catering, ushqim social, shërbime kulinari, gurme, Delivery (Shpërndarje në adrese të porositesit), shërbime në fushën e bar-kafe-restorant, menaxhim në fushën e bar-restoranteve, bar-kafe, veprimtari në fushën e turizmit, organizim eventesh, konsulence në fushën e bar-restoranteve, përgatitje stafi për bar-restorante, etj. Në përgjithësi shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme të lejuar nga ligji për relizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Shoqëria mundet gjithashtu të ushtrojë çdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti të ligjshëm dhe/ose mund të angazhohet në çdo veprimtari të ligjshme ose aktivitet të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e



nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (nje) kuotë.

Kapitali themeltar përbëhet si më poshtë:

- **Z. Mariglen Gjata**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **z.Mariglen Gjata**, shtetas shqiptar, atësia Genci, lindur më 03.10.1995, në Tiranë, banues në: Bejte Bulticë 0400011; Nd 5, H 1, Bejte, Bulticë, Vaqarr, Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 031451156 me ID J51003115P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratorin, **Z. Mariglen Gjata**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKET THEMELUES

MARIGLEN GJATA